

VENDIM
Nr 155, datë 29.12.2014

**PËRMIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2014, pasishqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.68, datë 23.6.2008, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.43, datë 13.5.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE, ndryshohet si më poshtë.

Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012, do të shtrijë efektet deri në datën 31.3.2015.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti